

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 3492 Prot

Tiranë, më 10/06/2020

URDHËR

Nr. 167, datë 10.06.2020

“PËR  
MARRJEN NË DORËZIM TË AKTEVE NOTERIALE, REGJISTRAVE DHE VULAVE  
TË NOTERIT”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar dhe të nenit 72, pika 5, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Në rastet kur noteri ka ndërruar jetë ose ndaj tij është zbatuar masa disiplinore pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në pesë vjet ose masa disiplinore e heqjes përfundimtare të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit, regjistrat, aktet noteriale dhe vulat merren në dorëzim nga një person i autorizuar nga Ministri i Drejtësisë dhe dega përkatëse vendore e dhomës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë urdhër.
2. Ministri i Drejtësisë përcakton me urdhër ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave, akteve noteriale dhe vulave me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Dega Vendore e Noterisë, anëtar i së cilës ishte noteri.
3. Për marrjen e regjistrave, akteve noteriale dhe vulave, personi (ish-noteri; personi i ngarkuar prej tij përmes prokurës së posaçme apo personi që ka në ruajtje arkivin), njoftohet të paktën 5 ditë përpara për ditën dhe orën e dorëzimit dhe i jepet edhe një kopje e urdhrit të Ministrit përmes shërbimit postar dhe/ose në rrugë elektronike.
4. Kur personit nuk i dihet vendbanimi, si dhe kur njoftimi nuk mund të kryhet në asnjë prej vendeve të përcaktuara në nenin 151 të Kodit të Procedurës Administrative, kryhet njoftimi publik sipas parashikimit të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative.
5. Komisioni i marrjes në dorëzim të arkivës merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.
6. Pasi regjistrat dhe aktet noteriale janë marrë në dorëzim nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë dhe nga përfaqësuesi i degës përkatëse të noterisë, ai i dorëzohet me procesverbal

një noteri të së njëjtës degë dhe që ushtron aktivitetin në një zyrë të ndodhur në të njëjtën bashki. Kur nuk ka një zyrë tjetër në atë bashki, arkivi i dorëzohet një noteri të një zyre të ndodhur në bashkinë më të afërt.

7. Kur ndaj noterit është dhënë masë disiplinore për heqje të licencës apo ka ndërruar jetë, vulat nxirren jashtë përdorimit me procesverbal nga një komision i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë ku përfshihet një nëpunës i Ministrisë së Drejtësisë, një anëtar i degës vendore ku noteri ka qenë anëtar si dhe një përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.
8. Kur ndaj noterit është dhënë masë disiplinore pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në pesë vjet, komisioni i marrjes në dorëzim të arkivës merr në dorëzim me procesverbal vulën e njomë dhe vulën e thatë të noterit me qëllim ruajtjen në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë.
9. Në rast se regjistrat, aktet noteriale dhe vulat janë marrë përkohësisht (kur është dhënë masa disiplinore për pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në 5 vjet) pas përfundimit të periudhës së pezullimit, nxirret urdhër për dorëzimin e arkivit noterit që e ka pasur. Noteri merr arkivin me procesverbal nga noteri që e kishte gjatë kësaj kohe në prezencë të një përfaqësuesi të Ministrisë së Drejtësisë dhe Degës Vendore të Noterisë. Noterit i dorëzohen me procesverbal në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë vulat noteriale.
10. Në rast moszbatimi vullnetar, urdhri i Ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e akteve noteriale të arkivit të noterit, regjistrave dhe vulave të përmendura në këtë urdhër, përbën titull ekzekutiv.
11. Ministria e Drejtësisë merr masa për ndjekjen e procedurave ligjore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit mbi titullin ekzekutiv. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon sektorit të përfaqësimit gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Sektori i përfaqësimit gjyqësor paraqet në gjykatë kërkesën brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuara në pikën 3 dhe 4 të këtij urdhri. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon zyrës së përmbarimit shtetëror vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.
12. Komisioni i marrjes në dorëzim të arkivës merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale pjesë të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.
13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë.
14. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI  
ETILDA GJONAJ (SALIU)

